



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**



KOMISIONERI

ilirjan.celibashi@cec.gov.al

www.cec.org.al

RELACION

PËR PROJEKTRREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”

Në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, gerëma “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projekt-rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor ”.

Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ), niveli i dytë i administratës zgjedhore që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore, kryen detyra të rëndësishme për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Kryerja e detyrave dhe përmbushja e përgjegjësisë nga KZAZ, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, ndërvaret nga shkalla e administrimit profesional dhe jo-partiak të procesit, si dhe nga transparenca e plotë së ofruar për vëzhguesit e akredituar, të partive politike, të shoqërisë civile apo të organizatave ndërkombëtare. Një proces zgjedhor demokratik përcaktohet nga qytetarët aktivë së pari si votues, vëzhgues, kandidatë, por edhe si komisionerë zgjedhorë apo numërues votash të cilët duke ju përmbajtur parimeve të ligjshmërisë, pavarësisë, paanësisë, ndershmërisë, sjelljes etike, transparencës dhe llogaridhënies rrisin besimin publik në administrimin e procesit zgjedhor.

Në vlerësim të rolit dhe rëndësisë së detyrave të KZAZ-së, projekt-rregullorja përcakton dhe detajon rregullat për organizimin dhe funksionimin e punës dhe të mbledhjeve të KZAZ, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Projekt-rregullorja e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, përbëhet nga 32 nene, strukturuar në 9 Krerë, të trajtuara si më poshtë:

Kreu I-rë – Përmban dispozita të përgjithshme si qëllimi, objekti, baza ligjore dhe parimet mbi të cilat në të cilat mbështetet veprimtaria e KZAZ-së. Në këto dispozita identifikohen fusha e veprimit të rregullores, baza ligjore, kompetenca territoriale dhe parimet mbi të cilat do të mbështetet funksionimi dhe veprimtaria e KZAZ-së gjatë përmbushjes së detyrave që i ngarkon Kodi Zgjedhor.

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së, thirrjes dhe zhvillimit të mbledhjeve, marrjes së vendimeve, si dhe për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore të miratuara nga KQZ-ja, si edhe rregullat mbi koordinimin e veprimtarisë administrative me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kreu II-të- në përmbajtjen e tij ka 10 nene të cilat reflektojnë rregullime mbi përbërjen e KZAZ-së, caktimin e partive politike që propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-së, afatet dhe mënyrën e kryerjes së procedurave për paraqitjen e propozimeve dhe emërimin e anëtarëve, sekretarëve, Kryetarëve dhe Zëvendëskryetarëve të KZAZ-së, rastet e shkarkimit/lirimit të anëtarit/sekretarit të KZAZ-së, dhe dorëzimit të detyrës.

Neni 3, një transpozim korrekt i nenit 29 të Kodit Zgjedhor identifikon përbërjen e KZAZ-së si organ kolegjal të përbërë nga 7 anëtarë dhe sekretari, procedurat për renditjen dhe caktimin e partive politike për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, afatet për paraqitjen e kandidatave, dhe rastet kur Komisioneri emëron “kryesisht” anëtarë të KZAZ-ve për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.

Në paragrafin 7 të këtij neni përcaktohet rasti kur Komisioneri emëron “kryesisht” sekretarët e KZAZ-ve për të siguruar funksionalitetin e KZAZ-ve. Neni 29 i Kodit Zgjedhor, shprehet për emërimin “kryesisht” të anëtarëve të KZAZ-ve për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, dhe nuk shprehet për emërimin “kryesisht” të sekretarëve të KZAZ-ve. Në vlerësim të përcaktimeve ligjore për rolin dhe detyrat e anëtarit të KZAZ-së dhe sekretarit të KZAZ-së, ku anëtari ka të drejtë vote, dhe sekretari nuk ka të drejtë vote por ka detyra shumë të rëndësishme për krijimin, administrimin e dokumentacionit zgjedhor si dhe mbarëvajtjen e punës së KZAZ-së, detyra këto të detajuara në nenet 34 dhe vijuesat të Kodit Zgjedhor, asnjë anëtar i KZAZ-së nuk mund të kryejë detyrat e sekretarit të KZAZ-së.

Historiku zgjedhor në lidhje me emërimin kryesisht nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fillon qysh në zgjedhjet vendore të vitit 2011. Në këto zgjedhje Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëroi plotësoi përbërjen e KZAZ-ve, nëpërmjet emërimeve kryesisht. Në vitin 2011 Kodi Zgjedhor nuk parashikonte praktikën e plotësimit të përbërjes së KZAZ-së përmes emërimeve kryesisht. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2012 reflektojnë praktikën e çelur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke normuar shprehimisht emërimin kryesisht të anëtarëve të KZAZ-ve kur ishte rasti si edhe duke deleguar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të miratojë procedurat për përzgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht (neni 29, paragrafi 5, nënparagrafi i dytë).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka reflektuar praktikën zgjedhore dhe delegimin ligjor në këtë drejtim duke miratuar në vitin 2013, Udhëzimin Nr.4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”. Ky akt normativ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

ka parashikuar rregullin për emërimin “kryesisht” edhe të sekretarëve të KZAZ-së për plotësim të vakancave të shkaktuara nga mosparaqitja e propozimeve nga partitë politike. Ky rregullim përmes aktit normativ, megjithëse pa autorizim të shprehur nga ligji, por si ushtrim diskrecional autoriteti në frymën e Kodit Zgjedhor, i zbatuar në zgjedhjet e vitit 2017 dhe në zgjedhjet e vitit 2019, tashmë është një praktikë e konsoliduar.

Neni 4, parashikon procedurat për hedhjen e shortit për materializim të kriterëve objektive të përzgjedhjes rastësore dhe shpërndarjes së barabartë në territorin zgjedhor të propozimeve të partisë së parë të shumicës parlamentare dhe të partisë së parë e opozitës parlamentare për anëtarin e 7-të të KZAZ-ve. Kodi Zgjedhor nuk e delegon shprehimisht vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shortit, por kjo mënyrë përzgjedhje është përdorur rregullisht në të gjitha procedurat zgjedhore të deritanishme dhe mendoj se shorti është mënyra më e mirë dhe e vetmja për të realizuar dhe përmbushur kërkesat dhe frymën e ligjit.

Neni 5, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në paragrafin 4, të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, parashikon procedurat e shortit ndërmjet partive politike që kanë fituar të njëjtin numër mandatesh dhe kanë të njëjtin numër votash në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin, për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ. Kodi Zgjedhor e delegon shprehimisht vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shortit, në rastet kur partitë politike kanë fituar të njëjtin numër mandatesh dhe kanë të njëjtin numër votash në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor për herë të parë parashikohet procedura e shortit në një akt normativ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet Rregullatorit.

Neni 6, përcakton afatet për dorëzimin nga ana e partive politike të kandidaturave për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, dhe dokumentacion përkatës për çdo kandidaturë të paraqitur, si dhe afati për paraqitje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të kërkesave nga shtetas të interesuar për t’u emëruar anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve. Afati për dorëzimin e kandidaturave për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, 105 ditë para datës së zgjedhjeve, është përcaktuar në referim të afatit ligjor të ngritjes së KZAZ-ve, 90-ditë para datës së zgjedhjeve. Periudha kohore nga paraqitja e kandidaturave deri në ngritjen e KZAZ-ve, është e nevojshme dhe e mjaftueshme për të kryer procedurat për verifikimin e kandidaturave dhe vendimmarrjen për emërimin e tyre.

Për herë të parë pjesë e dokumentacionit të kandidaturave propozohet të bëhet edhe deklarimi i nënshkruar i çdo kandidati të propozuar se gëzon të drejtën dhe vullnetin për t’u emëruar anëtar apo sekretar i KZAZ-së, ku përfshihet edhe deklarimi se kandidati nuk është në kushtet e papajtueshmërisë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së, sipas parashikimeve të nenit 30 të Kodit Zgjedhor. Vlerësojmë të rëndësishme përfshirjen e kësaj deklarate për të shmangur praktika të mëparshme ku në raste të caktuara kandidatët nuk ishin në dijeni të propozimit apo nuk ishin në dijeni të kushteve ligjore që të duhet të përmbushnin për të ushtruar detyrën.

Neni 7, përcakton procedurat për verifikimin e të dhënave të kandidatuarave të paraqitura për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, sipas kriterëve ligjore për kushtet dhe papajtueshmëritë me detyrën, afatin për plotësim të mangësive nga partitë politike, afatin për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në ushtrim të kompetencës së parashikuar në nenin 19, paragrafi 1, germa “ç”.

Gjithashtu, përcaktohet detyrimi i administratës së KQZ-së për paraqitjen e raportit për rezultatet e verifikimit, si rregull jo me vonë se 3 ditë nga dorëzimi i propozimeve nga partitë politike apo nga përfundimi i afatit për shprehje interesi nga shtetasit për emërim kryesisht anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së, tek Komisioneri dhe Nënkomisioneri (në bazë të përcaktimeve të paragrafit 1, neni 14, të Kodit Zgjedhor).

Paragrafi i tretë parashikon se administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit dhe Nënkomisionerit raport për rezultatet e verifikimit, si rregull jo me vonë se 3 ditë nga dorëzimi i propozimeve nga partitë politike apo nga përfundimi i afatit për shprehje interesi nga shtetasit për emërim kryesisht anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-së. Afati 3 ditor cmohet minimum i kohës së nevojshme për të verifikuar të dhënat e kandidatit në lidhje me gjendjen gjyqësore dhe vendbanimin.

Paragrafi 4 parashikon shprehimisht se “Partia politike, jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i Komisionerit për mangësi të propozimeve apo dokumentacionit të paraqitur, plotëson mangësitë ose ridepoziton propozim për zëvendësim të kandidaturës”. Mendoj se afati 24 orë është mëse i mjaftueshëm që partia politike të plotësojë mangësitë në dokumentacion.

Afati që Komisioneri jo më vonë se 93 ditë nga data e zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve i paraprin afatit ligjor prej 90 ditësh për ngritjen e KZAZ-ve.

Afati 90 ditor nga data e zgjedhjeve, kur partitë politike sipas parashikimeve të nenit 3 të rregulloreje nuk kanë propozuar anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve, për emërimin nga Komisioneri kryesisht të anëtarëve të KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje dhe/ose emërimin kryesisht të sekretarëve të KZAZ-ve, është në vlerësim të respektim të afatit ligjor prej 90 ditësh për ngritjen e KZAZ-ve.

Nenet 8 dhe 9 përcaktojnë afatet dhe procedurat që ndjek Komisioneri për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të KZAZ-ve, dhe për emërimin e Kryetarëve dhe Sekretarëve të KZAZ-ve.

Neni 10, përcakton shkaqet për të cilat Komisioneri, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, vendos shkarkimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, afatin e ankimit në KAS kundër vendimit të Komisionerit nga palët që demostrojnë interes të ligjshëm, si dhe pamundësinë e emërimit në përbërje të KZAZ-së të anëtarit të shkarkuar nga detyra.

Neni 11, përcakton shkaqet për të cilat Komisioneri, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, merr vendim për lirimin nga detyra të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së. Gjithashtu, përcaktohet detyrimi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për paraqitjen tek Nënkomisioneri, sipas rastit, të raportit për rezultatet e verifikimit për njoftimet e anëtarëve të KZAZ-së për egzistencën e kushteve të cilat përbëjnë shkak për lirim nga detyra, ose për vënien në dispozicion të kërkesës së subjektit zgjedhor për zëvendësimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, si rregull jo me vonë se 24 orë nga dorëzimi i kërkesës së partisë politike, (në bazë të përcaktimeve të paragrafit 1, neni 14, të Kodit Zgjedhor).

Neni 12, përcakton detyrimin e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së, të shkarkuar, liruuar apo dorëhequr nga detyra, për të mos u larguar nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij. Gjithashtu, përcaktohen procedurat që ndjek sekretari i KZAZ-së në rast të dorëheqjes së anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

Kreu III - në përmbajtjen e tij ka dy nene të cilat reflektojnë të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së. Parashikimet për të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së, referojnë kryesisht përcaktimet e neneve përkatëse të Kodit Zgjedhor, duke u qartësuar edhe me plotësime bazuar në praktikën zgjedhore apo të akteve nënligjore.

Kreu IV - në përmbajtjen e tij ka pesë nene të cilat reflektojnë detyrat e KZAZ-së, organizimin e Selisë së KZAZ-së, kohën e punës dhe dokumentet e identifikimit të KZAZ-së, vulën e KZAZ-së dhe përdorimin e saj.

Neni 15, përcakton detyrat e KZAZ-së, ku krahas atyre të parashikuara në nenin 33 të Kodit Zgjedhor, përcaktohen detyra që i shërbejnë organizimit dhe administrimit të procesit zgjedhor në ZAZ, të tilla si hartimi i planit të veprimeve ku parashikohen veprimtaritë, afatet dhe ndarja e detyrave, mbikqyrja dhe informimi për QV, dhe sipas rastit përshtatshmëria dhe aksesueshmëria për QV-të ku votojnë zgjedhës me aftësi të kufizuara, marrja e masave për mbarëvajtjen e trajnimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe dërgimi i informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për pjesëmarrjen, informimi për QV ku janë të rregjistruar zgjedhës të pakicave kombëtare, përgjegjësia për shpërndarjen dhe monitorimi i afishimit në QV të materialeve informuese dhe edukuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe sipas rastit edhe në gjuhë të pakicave kombëtare, dhe krijimi i hapësirës në VNV dhe afishimi në të i tabelave të rezultatit të QV-së/tabelës së rezultatit të ZAZ, dukë realizuar shikueshmërinë e tyre nga vëzhguesit.

Neni 16 dhe neni 17, përcaktojnë identifikimin e vendodhjes së Selisë së KZAZ-së përmes tabelës treguese me të dhëna të plota: numri i ZAZ-së, emrat e anëtarëve të KZAZ-së, pajisjen e saj me telefoni fikse dhe shërbim interneti, detyrimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ të mbajnë gjatë ushtrimit të detyrës dokumentin e identifikimit të funksionit, po ashtu detyrimin e vëzhguesve të akredituar të mbajnë dokumentin e identifikimit të lëshuar nga KQZ apo KZAZ së bashku me kartën e identitetit.

Neni 18, përcakton mënyrën e administrimit dhe përdorimit të vulës së KZAZ, procedurat në rast të dëmtimit apo humbjes dhe zëvendësimit të saj.

Neni 19, përcakton kohën e punës së KZAZ-së nga momenti i ngritjes deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, dhe qëndrimin në mënyrë të përhershme detyrë tre ditë para datës së zgjedhjeve deri në nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve, ku ndërprerjet e punës gjatë periudhës së dytë do të bëhen vetëm me vendim të KZAZ dhe do të shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Kreu V - në përmbajtjen e tij ka tre nene të cilat reflektojnë thirrjen, njoftimin, zhvillimin e mbledhjeve të KZAZ-së, dhe dokumentimin e tyre në procesverbal.

Neni 20, përcakton procedurat për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së parë të KZAZ-së.

Neni 21, përcakton procedurat për thirrjen dhe njoftimin e mbledhjeve të KZAZ-së gjatë kohës së funksionimit të saj.

Neni 22, përcakton rregullat për zhvillimin e mbledhjeve të KZAZ-së, për diskutimet dhe paraqitjen e propozimeve, për plotësimin e procesverbalit të mbledhjes.

Kreu VI- në përmbajtjen e tij ka katër nene të cilat reflektojnë vendimet e KZAZ-së, të drejtën dhe afatet e ankimimit ndaj vendimeve të KZAZ-së, si dhe konfliktin e interesit të anëtarëve të KZAZ-së gjatë marrjes e vendimeve.

Neni 23, parashikon procedurat për mbylljen e diskutimeve, të votimit të propozimeve dhe detyrimin e KZAZ-së për të dërguar tek Komisioneri, brenda 24 orëve, çështje për të cilat KZAZ nuk arrin të marrë vendim.

Neni 24, parashikon procedurat për marrjen e vendimeve nga KZAZ, zbadhjen, nënshkrimin, vulosjen e tyre, publikimin e vendimeve dhe detyrimin për plotësimin e kërkesave për kopje të vërtetuara të tyre, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 25, parashikon të drejtën e ankimimit kundër vendimeve të KZAZ-së dhe afatin e paraqitjes së ankimimit.

Neni 26, parashikon rastet e konfliktit të interesit të anëtarit të KZAZ-së, detyrimin e tij ose të çdo anëtarit tjetër që ka dijeni për ta deklaruar këtë fakt, njoftimin e Komisionerit për rastin, dhe pavarshmërinë e votës së anëtarit që gjendet në kushtet e konfliktit të interesit dhe mosllogaritjen e kësaj vote në kuorumin për vendimmarrje.

Kreu VII- në përmbajtjen e tij ka nenin 27, i cili reflektojnë dokumentacionin e punës së KZAZ-së ku pasqyrohet veprimtaria dhe rregjistrohen vendimet e KZAZ-së, shkresat e saj dhe të të tretëve drejtuar KZAZ-së, mënyrën e administrimit dhe dorëzimit të tij në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Kreu VIII- në përmbajtjen e tij ka dy nene, nenin 28 dhe nenin 29, të cilat reflektojnë përgjegjësitë e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së në rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor, si dhe sanksionet administrative që vendosen në këto raste.

Kreu IX - në përmbajtjen e tij ka katër nene.

Neni 30, parashikon të drejtën e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor të zhvillojë seancat online në raste të masave të jashtëzakonshme duke garantuar të drejtën për akses në këto sisteme nga pjesëmarrësit.

Neni 31 parashikon formimin kalimtar të KZAZ-ve për zgjedhjet e para për Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 183 të Kodit Zgjedhor.

Neni 32 dhe neni 33 parashikojnë shfuqizimin e Udhëzimit të KQZ-së nr. 2, datë 25.02.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar dhe hyrjen menjëherë në fuqi të kësaj rregulloreje dhe publikimin e saj faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI